



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, neneve 3.2 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, dhe nenit 14 dhe 12.2 shkronja d) të Statutit të Komunës, nr.01-11298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 11 maj 2018, miratoi;

### **VENDIM PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - KKS**

#### **Neni 1**

Themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në përbërje:

1. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Kryesues
2. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë
3. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame
4. Radisav Perovic, përfaqësues i komunitetit serb
5. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom
6. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete
7. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore
8. Agim Blakqori, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit
9. Naim Bajraktari, përfaqësues i FSK-së
10. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Kërpimëh
11. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Orllan
12. Rizah Muqolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
13. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile
14. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës komunale për Komunitete dhe Kthim
15. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

#### **Neni 2**

Këshilli themelohet në mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.

#### **Neni 3 -**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

#### **Neni 4**

Anëtarët e KKS-së, sipas këtij vendimi, për pjesëmarrje në mbledhje kompensohen nga buxheti i Komunës (kategoria paga dhe mëditje-Zyra e Kuvendit-kodi 16905), në shumë ekuivalente me anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe atë jo më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje brenda vitit kalendarik.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.01-020/04-0038894/18  
Podujevë, 11 maj 2018

